

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mevlide Shabani, me sekretaren juridike Hyrije Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditësit F. M., nga Gjilani, të cilin e përfaqëson Sabit Maliqi, avokat nga Gjilani, kundër të paditurit I. K., nga Gjilani, rr. ...., për shkak të pagimit të borgjit, pas mbajtjes së seancës kryesore, me datë 14.08.2013, në prezencë të paditësit dhe përfaqësuesit të tijë e në mungesë të të paditurit , bie këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit F. M., nga Gjilani, e ushtruar kundër të paditurit I. K., nga Gjilani, dhe **OBLIGOHET** i padituri që paditësit tia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 600.00 Euro, me kamatë bankare prej 3 %, duke filluar nga data 01.04.2011, si ditë e ushtrimit të padisë në gjykatë, e gjerë në pagesen definitive dhe të plotë të borgjit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kanosjen e përmabrimin të dhunshëm.

**II. OBLIGOHET** i padituri që paditëve tia kompezoj shpentzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 333 Euro, edhe ate 78 Euro për padi, 240 Euro për dy përfaqësime të avokatit dhe 15 euro për taksë gjyqësore, i padituri është i obliguar që kësaj gjykate tia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 50 Euro për hartimin e aktgjykimit, krejt këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Paditësi F. M., nga Gjilani, përmes përfaqësuesit me autorizim Sabit Maliqi, avokat nga Gjilani, në këtë gjykatë kanë ushtruar padi për pagimin e borgjit në vlerë prej 600.00 Euro, me kamatë bankare , ndaj të paditurit I. K., nga Gjilani.

Gjykata të paditurit në kuptim të nenit 394 të LPK-së , ia dërgoi padinë e paditësit , por i padituri nuk ka ushtruar përgjegjeje në padi.

Në seancën e shqyrtimit pergaditor paditësi nuk e ka pranuar kërkespadin njëherit e ka detyruar gjykatën që ta ndërpres seancën, lidhu me këtë qështje gjykata caktoi seanca mbi shqyrtimin kryesor, ku paditësi dhe përfaqësuesi i tijë mbeti pranë padisë dhe kërkespadisë, kurse i padituri nuk ka marr pjesë edhe pse i shte i ftuar në mënyrë të rregullt kurse mungësën nuk e ka arsyetuar, ashtu që gjykata me aktvendim procedural e me propozim të prfaqësuesit të paditësit mbajti shqyrtimin e fundit kryesor në mungesë të të paditurit.

Për të vërtetuar pretendimet e paditësit lidhur me bazën ligjorte të padisë dhe kërkesëpadisë, e me propozimin e përfaqësuesit të tijë, gjykata shtjelloi provat materiale me dëgjimin e paditësit F. M., në cilësi të palës , ndëgjoi dëshmitarët : Sh. B. dhe B. M..

Paditësi F. M., deklaroi se në muajin tetor 2007, në bazë të marrëveshjes gojore mbi shitblerjen i kishte dërguar të paditurit I. K., nga Gjilani, 50 m3 dru me qmim prej 15 Euro për një m3, me një shumë prej 800.00 Euro, duke theksuar se paditësi kishte shkuar në fsh. Lajqiq me kamionin e tijë dhe i kishte ngarkuar drunjët ndërsa pagesën ishin marë vesh që i padituri ta kryej pas një muaji. Përkundër marrëveshjes i padituri ndaj paditësit nuk e kishte kryer obligimin

marrë paditësit kishte paguar borgjin vetëm 200Euro, ndërsa shumën e të hollave prej 600 Euro, edhe pse paditësi i kishteërkuar rregullisht i padituri nuk ja kishte dorzuar.

Dëshmitari Sh. B., ka deklaruar se me të paditurin I., njihet më heret dhe ka lidhje miqësie, në tetor të vitit 2007, i padituri i kishte shkuar në shtëpi në fsh. Lajqiq, duke kërkuar që të kontaktojë me paditësin dhe me ndërmjetsim in e tijë ti marrë 50 metra<sup>3</sup> dru ndërsa për pagesë ishin marë vesh që të kryhej pas një muaji. Pagesa për një metër ka qenë 15 euro ndërsa shuma e përgjithshme ishte prej 800 euro, pasi kishte kaluar një muaj paditësi ka kërkuar nga i padituri t'ia kompensoi shumën e të hollave që i kishte mbetur borgj por pas 7-8 mujsh ja kishtepaguar shumën vetëm prej 200 Euro, ndërsa i kishte mbetur borgj edhe 600 Euro.

Dëshmitari B. M., po ashtu ka deklaruar se paditësi në bayë të marrëveshjes i ka dorzuar 50 m<sup>3</sup> dru të paditurit por i njëjti nuk i kishte paguar çmimin kontraktues sipas marrëveshjes.

Pas shtjellimit të provave, analizimit dhe çmuarjes së tyre veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8. të LPK, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike,

Se palët ndërgjyqëse në muajin tetor të vitit 2007, kishin lidhë kontratë gojore mbi shitblerjen e 50 m<sup>3</sup> dru dhe ishin marrë vesh që i padituri brenda një muaji pas pranimit të drunjtëve ta kryej obligimin e pagesës paditësit edhe ateshumën prej 800.00 Euro

I padituri kishte kryer obligimin vetëm për 200 Euro, ndërsa i kishte mbetur borgj paditësit edhe shumën prej 600.00 Euro.

Këto fakte gjykata i vërtetoi në bazë të deklaratës së paditësit F. M. dhe të dëshmitarëve Sh. B. e B. M..

Gjykata aprovoi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit si të bazuar me ligj ,dhe obligoi të paditurin që paditësit t'ia paguaj shumën e të hollave prej 600.00 Euro, për shkak të borgjit të mbetur.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore është marur bazuar në nenin 452 paragraf .1 të LPK-së.

Nga provat e shtjelluara dhe të theksuara më lartë dhe bazuar në nenin 143 par.1. dhe 146 par.1. të LPK gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**me datë 14.08.2013**

**Gj y k a t ë s j a ,**  
**Mevlide Shabani**

**KËSHILLA JURIDIKE:**kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njejtës.

Aneksa sorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj Gjykate.